**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**KËSHILLI I MINISTRAVE**
**KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

# VENDIM

Nr. 11, datë 27.02.2019

**PËR**

**MIRATIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN: "KOMPLEKSI PËR GRUMBULLIMIN, PËRPUNIMIN DHE SHITJEN E PRODUKTEVE BUJQËSORE, AGRO – KULTURORE DHE PEMËTARISË, ME VENDNDODHJE NË SPITALLË, BASHKIA DURRËS"**

Në mbështetje të neneve 28 dhe 29, të Kodit të Procedurave Administrative; neneve 14/1, pika 2, 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar; neneve 9 dhe 10/1, të Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar; Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit", i ndryshuar, me propozim të shoqërisë "Naim Tragaj Group" sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: "Kompleksi për grumbullimin, përpunimin dhe shitjen e produkteve bujqësore, agro – kulturore dhe pemëtarisë, me vendndodhje në Spitallë, Bashkia Durrës", me subjekt zhvillues shoqërinë "Naim Tragaj Group" sh.p.k.

2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**EDI RAMA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT
KËSHILLI I MINISTRAVE

MINISTËR I LINJËS

**MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL**

**BLEDI ÇUÇI**

ANËTAR / SEKRETAR I KKT

**DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**

**LEDIA TOTA**